



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7215/20 datë:05.05.2020



Npi – 01/89 datë: 14.05.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/11, të datës 15.03.2020, për shpalljen e gjendjes emergjente për shëndetin publik, Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi propozimin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA TAKSA KOMUNALE

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 14.05.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për lirim nga Taksa Komunale, të gjithë personat fizik dhe juridik, në komunën e Shtimes, si vijon:

1. Lirohen nga pagesa e Qirasë, për bizneset që janë të vendosura në Zonën Ekonomike si dhe ato që janë të vendosura në pronat tjera të Komunës, e që janë në shfrytëzim të pronës Komunale,
2. Lirohen nga pagesa e Taksës Komunale, personat që duhet të pajisen me Leje Çarkullimi për automjetet e rënda motorike për rrugët lokale (qendër) ku është i ndaluar qarkullimi i automjeteve,
3. Lirohen nga pagesa e Taksës Komunale, të gjithë shfrytëzuesit e Pronës Komunale me destinacion të përkohshëm,
4. Lirohen nga pagesa e Taksës Komunale, shfrytëzuesit e hapsirave të tregut për vitin 2020,
5. Lirohen nga pagesa të gjithë prindërit, fëmijët e të cilëve vijnë në institucionin parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime për periudhën kohore nga pezullimi i aktiviteteve parashkollore deri në fillim e tyre,

II

A r s y e t i m: Ky Vendim është aprovuar nga Kuvendi, me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare, për shkak të pandemisë COVID – 19, që ka rezultuar me pezullimin e shumë aktiviteteve, për këtë arsye lirohen nga pagesa e obligimeve komunale sipas dispozitivit të këtij vendimi, të gjithë personat fizik dhe juridik.

III

Varësisht nga zhvillimet lidhur me Pandeminë KOVID-19, i njohur si gripi Korona-Virus, Kuvendi i Komunës së Shtimes, këtë Vendim mund ta plotësojë, ndryshojë ose anulojë.

IV

Kompetent për zbatimin e këtij Vendimi janë: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria Komunale për Arsime si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

V

Ky vendim, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

VII

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj